



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 111/2013
Prishtinë, më 26.06.2013, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N–303

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, kryetar, Fikrim Damka, Lutfi Zharku, Visar Ymeri dhe Myzejene Selmani.

Munguan: Teuta Sahatqija, Sala Berisha–Shala, ShaipMuja, Hashim Deshishku, Ramiz Kelmendi dhe Biserka Kostiq.

Pjesëmarrës të tjerë: Remzije Hajdari, Blerim Ahmeti dhe Muhamet Bytyçi –MTI; Ukë Gashi-ZPRK; Darsei Canhasi dhe Arbër Fetahu –INDEP dhe Arsim Rashiti-Kosova-live-Gazetar.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 18.06.2013;
3. Shqyrtimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit Nr. 04/L-047 për Masat Mbrojtëse në Importe;
4. Shqyrtimi i Raportit me Propozim-amendamente për Projektligjin Nr.04/L-198 për tregtinë e mallrave strategjike;
5. Te ndryshme;

Kryetari, konstatoi se nuk janë plotësuar kushtet për hapjen e kësaj mbledhje sepse nuk ka kuorum, pasi që mungojnë disa anëtarë të komisionit. Por propozoi që në këtë mbledhje vetëm të shqyrtohen çështjet ndërsa në mbledhjen radhës mund ti votojmë.

Anëtarët e Komisionit u pajtuan me propozimet e kryetarit.

1. Shqyrtimi i Raportit me Propozim-amendamente për Projektligjin Nr.04/L-198 për tregtinë e mallrave strategjike

Kryetari - Theksoi se për Projektligjin Nr.04/L-198 për tregtinë e mallrave strategjike, që janë hartuar 31 propozim amendamente nga grupi punues janë kryesisht teknike, pastaj filloi prezantimin e amendamenteve një nga një.

Deputetët e as përfaqësuesit e MTI nuk patën vërejtje në propozim amendamente dhe unanimisht u pajtuan që Raporti me Propozim-amendamente për Projektligjin Nr.04/L-198 për tregtinë e mallrave strategjike, të miratohet në mbledhjen e radhës.

2. Shqyrtimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit Nr. 04/L-047 për Masat Mbrojtëse në Importe.

Kryetari – Ne cilësinë e kryesuesit të grupit punës për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit Nr. 04/L-047 për Masat Mbrojtëse në Importe, tha që grupi punues ka punuar në bazë të Planit të Veprimit. Theksoi se tani është hartuar raporti final më disa rekomandime. Dhe, kërkoi nga deputet e Komisionit dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë që gjatë shqyrtimit mund të japin sugjerimet dhe vërejtjet e tyre për rekomandimet.

Lutfi Zharku – tha se kam vërejtje në faqen 9 të Raportit dhe kjo duhet të plotësohet me të dhëna shtesa sepse në bazë të gjeturave ka shkelje jo vetëm të nenit 9 që është potencuar por edhe shkelje të nenit 6; nenit 12.1; nenit 16.1 dhe nenit 19.6 por ai tha se do të paraqes më shkrim dhe do të përfshihen në raport.

Visar Ymeri – tha se rekomandimi i parë që është plotësuar ndryshimi i ligjit duhet të riformulohet në pikat që janë paraqitur të ndryshohet për shkak që të jetë më i qartë rekomandimi bazë.

Deputetët unanimisht u pajtuan që më këto ndryshime të procedohet për mbledhjen e radhës vetëm të votohet Raporti me Rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit Nr. 04/L-047 për Masat Mbrojtëse në Importe.

3. Të ndryshme Çështjet vijuese

Kryetari, propozoi që të ftohen në mbledhjen e radhës anëtarët e Bordit të Autoritetit të Konkurrencës për shkak të disa shqetësimeve që i kanë paraqitur përmes kërkesave të dërguara. Po ashtu propozoi që mbledhjen e radhës të shqyrtohet raporti i Komisionit Qeveritar për Privatizimin e 75 % të aksioneve të PTK-së.

Deputetët u pajtuan me propozimet e kryetarit.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

**Kryetar i Komisionit,
Zenun Pajaziti**